



Datë: 08.08.2025
Numër Protokolli: 5528/2025

A.nr. 1250/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli- në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1250/2025, të datës 30.06.2025, të parashtruar nga ankuesja H.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar A.nr.1250/2025, të datës 30.06.2025, të parashtruar nga ankuesja H.H.

II. Shfuqizohet Njoftimi i datës 07.07.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa **Anulohet** në tersi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 08.05.2025 me numër të Referencës RN000178374 për pozitën “*Inspektor Shërbimeve Publike*”, në Komunën e Prishtinës.

III Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Njesisë për Menagjimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **III** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, H.H (me tej referuar vetëm ankuesja), më datë 30.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 1250/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00017837, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, titulli i pozitës: Inspektor i Shërbimeve Publike klasa- profesional 1, me pretendimet ankimore se në mënyrë të pa drejtë më është refuzuar aplikacioni në fazën e verifikimit parapara. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 23.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 25.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova; Ankesën A.Nr. 1250/2025 të datës 30.06.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kopja e letërnjoftimit e ankueses; Vendimin e datës 22.06.2025 me të cilin ankueses i është refuzuar aplikacioni; Aplikacionin e ankueses të datës 25.05.2025, aplikacionin e kandidatës fituese; Përgjigjen nga Komuna e Prishtinës e datës 25.07.2025; Konkursin RN00017837 të datës 08.05.2025 me afat aplikimi nga data 09.05.2025 deri më datë 07.06.2025; Vendimin nr.14-020/04-70550/25 të datës 21.05.2025; Njoftimin për verifikim paraprak; Rezultatet e testimit me shkrim të kandidatëve që kanë marrë pjesë;

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Prishtinës më datë 08.05.2025 ka bërë njoftimin për publikimin e konkursit për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, titulli i pozitës-Inspektor i Shërbimeve Publike, Klasa e pozitës-Profesional 1, numër i kërkuar 1 për këtë pozitë, me afat aplikimi prej datës 09.05.2025 deri më 07.06.2025.

Kolegji fillimisht është kujdesur për të konstatuar se konkursi i shpallur është në harmoni me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në shërbimin Civil, si dhe në përputhje me katalogun vendeve të punës i cili është i evidentuar me shenjë nr. 85 SHC profesional 1.

Kriteret formale të konkursit sipas pikës 3 kanë qenë si vijon:

- **Arsimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë KKK;
- **Kërkesa specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.

Kolegji i Këshillit bazuar në Ligjin Nr.05/L031 gjegjësisht neni 86 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “ **Shqyrtimi administrativ sipas detyrës zyrtare 1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.** Prandaj nisur nga kjo dispozitë Kolegji ka vlerësuar me kujdes dosjen e ankuese H.H në këtë procedurë e cila pretendon se i është bërë e pa të drejtë kur i është refuzuar aplikacioni, andaj nga vlerësimi i dosjes së ankuese e dërguar nga Komuna e Prishtinës konstatohet se ankuesja në dosje ka të bashkëngjitur si vijon: aplikacionin e datës 25.05.2025, kopjen e letërnjoftimit dhe një vërtetim të kaluarës kriminale i cili mban datën 31.10.2024 i gjeneruar në mënyrë elektronike nga sistemi e Kosova, ashtu që nisur ngase u tha më lartë pretendimi i ankueses së i është bërë e pa të drejtë kur i është refuzuar aplikacioni në mungesë të diplomës është i pa qëndrueshëm, sepse NJMBNJ e Komunës së Prishtinës ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, gjithashtu ankuesja edhe në ankesën e saj nuk ka bashkëngjitur diplomën.

Pavarësisht që nuk qëndrojnë pretendimet e ankueses Kolegji i Këshillit bazuar në mandatin Kushtetues dhe ligjor nisur nga neni 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “ Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës”, si

dhe bazuar në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 7 paragrafi 1 ku përcaktohet se “ **Parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik** 1. *Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese*”, si dhe duke u mbështetur Ligjin Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht në nenin 88 ku përcaktohet se” **Mjetet e provës** 1. **Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore.** 2. **Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen** dhe neni 89 **Vlerësimi i provave Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ**” Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidatës që është shpallur fituese D.M dhe ka konstatuar si vijon: Diplomën e datës 26.10.2021 Nr.2592/21 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet në programin e Gjuhës Angleze dhe ka marrë gradën Baçellor i Arteve në Gjuhën Angleze me datë 13.10.2021 në Kolegjin AAB, e njëjta ka bashkëngjitur edhe një numër të certifikatave por të cilat nuk janë kërkuar në konkurs; Kontratë për Punë të Caktuar në mesë ËORLD SH.P.K dhe D.M nga data 01.09.2022 deri më datë 31.05.2023, kontrata nuk ka vullë të protokollit po vetëm vullën e rrumbullakët;; Kontratë për Punë të Caktuar në mesë ËORLD SH.P.K dhe D.M nga data 01.01.2024 deri më datë 29.02.2024, kontrata nuk ka vullë të protokollit por vetëm vullën e rrumbullakët; kontratë punë për kohë të pacaktuar në mesë Mabeko Grup Shpk dhe D.M nga data 01.03.2024 në kohë të pacaktuar, kontrata nuk ka vullë të protokollit po vetëm vullën e rrumbullakët; Kontratë për Punë të Caktuar në mesë ËORLD SH.P.K dhe D.M nga data 01.07.2024 deri më datë 30.09.2024, kontrata nuk ka vullë të protokollit por vetëm vullën e rrumbullakët; Vërtetim nga Komuna e Prishtinës nr. 14113/01-65823/24 të datë 14.05.2025 më të cilën dëshmohet se e njëjta ka mbajtur praktikën në Komunën e Prishtinës nga data 04.11.2024 deri me datë 03.02.2025 dhe nga data 05.02.2025 deri në datë 04.05.2025 (që i bie gjithsejtë 7 muaj). Gjithashtu kandidatja fituese ka bashkëngjitur edhe pasqyrën nga trusti i kursimeve pensionale, prandaj Kolegji duke u thirrur në dispozitat e lartshënuar ligjore ka konstatuar se kandidatja fituese ka bërë pagesën në trustin e kursimeve pensionale apo kompania ËORLD SH.P.K me datë **26.05.2025** për periudhën si vijon: 09-2022; 10-2022; 11-2022; 12-2022; 01-2023; 02-2023; 03-2023; 04-2023; 05-2023; 06-2023; 07-2023; 08-2023; 09-2023; 10-2023; 11-2023; 12-2023; 01-2024; 02-2024, respektivisht pas shpallës së konkursit RN00017837 me afat aplikimi nga data 09.05.2025 deri më datë 07.06.2025, ndërsa kandidatja D.M ka aplikuar me datë 28.05.2025 si rrjedhojë e kësaj që u tha dhe nisur nga ajo që as kontratat që janë bashkëngjitur si dëshmi për të dëshmuar përvojën e punës nuk kanë vullë të protokollit, Kolegji i Këshillit kësaj përvoje të punës NUK ja falë besimin dhe kandidatja nga dëshmitë tjera mund ti llogariten 14 muaj përvojë punë që nuk janë të mjaftueshme sipas pikës tre të konkursit. Prandaj sipas mendimit të Kolegjit NJMBNJ e Komunës së Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 7 paragrafi 1 ku përcaktohet se “ **Parimet e pranimit në detyrë të zyrtares/it publik** 1. *Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese*”

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1250/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, H.H.
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Divizionit për Burime Njerëzore në K-Prishtinë;
- dhe Arkivit të KPMSHCK-së